



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2021:264652
Datë: 15.08.2024
Numri i dokumentit: 06055415

C.nr.293/21

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, gjyqtarja Sabaheta Kurteshi, me bashkëpunëtorin profesional Gjelbrim Gërdellaj, në çështjen kontestimore sipas padisë së paditëses **M. J. nga fshati..., Komuna e Dragashit,** të cilën e përfaqëson i autorizuari i saj **av. M. S. nga Dragashi,** kunder të paditurve: **Sh. A. dhe N. A. të cilin e përfaqëson sipas autorizimit N. A. nga fshati R.,** me objekt kontesti vërtetimi i pronësisë, me datë 29.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. NDERPRITET procedura në këtë çështje kontestimore, për shkak të vdekjes së të paditurit Sh. A. ish nga fshati..., Komuna e Dragashit.

II. Procedura do të vazhdohet kur trashëgimtarët e të paditurit e marrin përsiper procedurën apo kur gjykata i therret ta bejnë këtë pas propozimit të palës kundërshtare.

A r s y e t i m

Paditesi M. J. nga fshati..., Komuna e Dragashit, përmes të autorizuarit të saj av. M. S. nga Dragashi me dt. 23.11.2021 ka paraqitur padin kunder të paditurve: Sh. A. dhe N. A. të cilin e përfaqëson sipas autorizimit N. A. nga fshati R., me objekt kontesti vërtetimi i pronësisë.

Gjykata në këtë çështje kontestimore ka caktuar seancën përgatitore në të cilën ka marr pjesë i autorizuari i palës paditëse av. M. S. nga Dragashi dhe i autorizuari i të paditurit të rendit të dytë – N. A. nga fshati..., Komuna e Dragashit, ndërsa ka munguar Sh. A., ndërsa nga konstatimi i dorëzuesit të kësaj gjykate të dt. 30.01.2024 është konstatuar se pala Sh. A. ka vdekur.

Ndërkaq i autorizuari i palës paditëse av. M. S. e ka njoftuar gjykatën se i padituri i rendit të parë Sh. A. ka ndërruar jetë dhe i ka dorëzuar gjykatës një kopje të Certifikatës së vdekjes të dt. 29.07.2024

Pasi që pala e paditur ka vdekur gje që vërtetohet nga certifikata e vdekjes me numer serik V 1069... dhe numër reference 1./2023RV/170.. të datës 29.07.2024, gjykata në kuptim të nenit 280 paragrafi 1 lidhur me nenin 277 paragrafi 1 germa (a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të aktvendimit.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PËR ÇËSHTJE CIVILE**

2021:264652, 29.07.2024

G j y q t a r j a,

Sabaheta Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur mund te paraqet ankes në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimt të këtij aktvendimi .